

AKTI I THEMELIMIT

I

SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ELITA ‘S’ HOLDINGS” Sh.p.k

Themeluesi qe nenshkruan me poshte eshte si vijon:

Z. ERGI STAFA i datelindjes 17.07.1994, lindur ne Durres, atesia Osman, shtetas shqiptar, mbajtes i pasaporte shqiptare nr. BA3598880 dhe nr personal J40717085I banues ne Rajoni 5, Lagja 13, Durres, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

Z. REIMAN STAFA i datelindjes 26.07.1998, lindur ne Durres, atesia Osman, banues ne Rajoni 5, Lagja 13, Durres, shtetas shqiptar, mbajtes i pasaportes shqiptare me nr. BE1283771 dhe nr personal J80726059W, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

Qe ne vijim do te quhen Ortaket e Shoqerise “ELITA “S” HOLDINGS” Sh.p.k

Sot me date **16.01.2023**, bazuar ne vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, vendosen te themelojne Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

Kreu I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1

Objekti i shoqerise

Shoqeria Tregtare “ELITA “S” HOLDINGS” Sh.p.k, ka si objekt veprimtarie:

1. Konsulencë për tregti dhe ndërtimit të marrëdhënjëve korporative ndërkombëtare. Veprimtari ne fushen e konsulences teknike per te gjitha fushat e ekonomise, kryerje studimesh komplekse per dege te ndryshme transporti te levizjes se mallrave, kryerje studimesh ekonomike-financiare, konsulence ne fushen juridike dhe administrative.
2. Konsulencë, shërbime në fushën e pasurive të paluajtshme, duke përfshirë shitje, blerje, marrje e dhënie me qira. Menaxhimi i pronave te paluajtshme si edhe ndermjetesimi per shitje blerje apo dhenie me qera te pronave te paluajtshme midis personave fizike, personave juridike private dhe publike. Negocime, ndermjetesime, perfaqesime te te treteve ne fushen e real estate si ne tregun e brendshem ashtu edhe ne ate nderkombetar.
3. Menaxhimi i projekteve me rendesi private e publike, projektimin, prodhimin, shitjen, tregtimin, koncensionin per perdorim me qera te te mirave dhe sherbimeve ne pergjithesi, ente publike apo private ne Shqiperi apo jashte saj. Qofshin keto projekte madhore per prodhim energjie hidrike, eolike, fotovoltaike, cdo lloj energjie te rinovueshme. Komplekse ndertimi per banim, kompleks turistik.



4. Te perfitoje, transferoje, te marre apo jape me qera, te bleje dhe shese, si dhe te kontraktoje, te drejten e markes, patentes, licences, dhe te drejtat e tjera qe jane te ngjashme me keto. Marrjen e cdo distributori, franchise, ekskluzivitet per produkte dhe materiale te cdo lloj fushe

Neni 2

Emertimi dhe Selia Juridike e Shoqerise

Ortaket vendosen qe shoqerine t'a emertojne "ELITA "S" HOLDINGS" Sh.p.k

1. Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne Rruga Taulantia, Pallati Oxholli Nr 2. Ap.36, Durres
2. Shoqeria mund te krijojte qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

Neni 3

Forma Juridike

1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi
2. Me vendim te ORTAKEVE mund te ndryshoje formen juridike te Shoqerise, ne qofte se ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast Ortaket do te pershtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te bejne regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar, ne organet kompetente shqiptare.
3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe ne perputhje me ligjin.
4. Shoqeria do te kete vulen e saj.

Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4

Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakeve

1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.
2. Shoqeria gezon te drejten te krijojte pasuri materiale dhe intelektuale.
3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne nje shoqeri tjeter ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.
5. Ortaket marrin pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vet ose nepermjet perfaqesuesve te tij.
6. Ortaket kane te drejte te marrin te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike



Neni 5

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar.

Kreu III

KAPITALI THEMELTAR

Neni 6

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar është **100.000 (njqind mije) Leke**. E ndare në 2 (dy) kuota.

Ortaket e shoqërisë janë:

ERGI STAFA, zotërues i **50% (pesdhjete) te kuotave të kapitalit të shoqërisë;**

REIMAN STAFA zotërues i **50% (pesdhjete) te kuotave të kapitalit të shoqërisë;**

Kreu IV

PERSONALITETI JURIDIK

Neni 7

Shoqëria fiton personalitetin juridik në ditën e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar në Qendren Kombëtare të Regjistrimit në Tiranë, si dhe fillon veprimtarinë e saj me marrjen e licences të ushtrimit të veprimtarisë.

Kreu V

ADMINISTRIMI

Neni 8

1. Shoqëria do të administrohet nga administratori **ERGI STAFA**, e cila përfaqëson shoqërinë në marrëdhëniet me të tretet për një periudhë **5 (pese) vjetore** dhe me të drejtë rizgjedhje.
2. Administratori mund t'i delegojë kompetencat e tij me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.

Kreu VI

DISPOZITA TË TJERA

Neni 9

1. Fitimi i realizuar nga Shoqëria, pas shlyerjes së detyrimeve ligjore, do t'i mbetet Ortakut të saj, ta ndajë si dividend apo ta shtojë në kapitalin e shoqërisë.
2. Ky Akt shtypet dhe nënshkruhet në 4 (kater) kopje, të gjitha me të njëjten vlerë ligjore.
3. Një kopje qëndron në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

ORTAKET THEMELUES

ERGI STAFA



REIMAN STAFA

